



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
"HASAN PRISHTINA"
UNIVERSITY OF PRISHTINA

Rr. Xhorxh Bush, Ndërtesa e Rektoratit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +381 38 244 183 • E-mail: rektorati@uni-pr.edu • www.uni-pr.edu

Nr. Prot.: 4/203
Datë: 22/12/2021


Këshilli Drejtues i Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina", në vazhdimin e mbledhjes së datës 09.12.2021, të mbajtur më datë 15.12.2021, merr këtë:

V E N D I M

- I. Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina" për vitin akademik 2021/2022 do të ndajë bursa për të gjithë studentët e nivelit bachelor, të cilët i plotësojnë kriteret e propozuara sipas konkursit publik.
- II. Lartësia e bursës universitare për vitin akademik 2021/2022, për çdo përfitues do të jetë në lartësi prej 600 euro, e cila ndahet për rezultatet e arritura gjatë vitit akademik 2020/2021. Bursa ndahet për periudhën e studimeve, përkatësisht për 10 muaj të vitit akademik.
- III. Për studentët përfitues të bursës universitare, transferimi i mjeteve do të bëhet në llogaritë personale, brenda vitit akademik 2021/2022.
- IV. Shërbimi financiar i njëjësive akademike në bashkëpunim me shërbimin financiar të Universitetit të Prishtinës, obligohen që të zbatojnë këtë vendim.
- V. Ky vendim hyn në fuqi nga dita e nënshkrimit.

Vendimi t'u dorëzohet:

1. Arkivit të UP-së,
2. Njëjësive akademike të UP-së,
3. Këshillit Drejtues të UP-së,
4. Shërbimit financiar të UP-së,
5. Zyrës ligjore të UP-së,
6. Asistentes së KD-së.



Këshilli Drejtues i UP-së
Dr. Arbëresha Nela Turjaka - kryesuese